



## "SuperPuna", nga shpresa për të rinjtë deri te dëshpërimi

Shkruan: Sefer Zogaj

"Duam punë", ka qenë një nga sloganet më të përdorur në Kosovën e pasluftës. Mungesa e perspektivës në Kosovë shumë të rinj i ka vendosur në mes pritjes për një vend pune dhe emigrimit nga Kosova.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikaev të Kosovës ([ASK](#)), për tremujorin e fundit të vitit 2024, papunësia e të rinjve 18-24 vazhdon të jetë mbi mesataren e papunësisë së përgjithshme. Teksa norma e papunësisë që përfshin të gjitha grupmoshat është 10,9%, për të rinjtë kjo normë është 18,4%. Brenda kësaj kategorie gratë janë më të papunësuar sesa burrat 23,7%, krahasuar me burrat 15,5%.

Fakti që grupmoshat rinore përballen me mungesë të perspektivës ishte konfirmuar nga vetë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili më 24 prill të vitit 2023, referuar statistikave të ASK-së, kishte deklaruar se 100 mijë të rinj jetojnë pa asnjë aktivitet, pra "pa punë, pa shkollë e pa trajnime", apo 30% e grupmoshës 18-24 vjeç.

Gjendja akoma më e rëndë është në komunitetet joshumicë në Kosovë.

"Ne e dimë se ka një numër të madh të të rinjve që përveç se nuk janë në punë, nuk janë as në shkollë e as në fakultet, e as në ndonjë trajnim. 30% e të rinjve të moshës prej 15 deri në 24 vjeç janë në një gjendje të tillë. Kurse, në disa nga komunitetet joshumicë në Kosovë, përqindja e të rinjve pa punë, arsim apo trajnim është edhe më e lartë sesa kaq", kishte [thënë](#) Kurti.

Referuar të dhënave zyrtare, papunësia në Kosovë kryesisht shënon ulje, gjithnjë referuar kësaj grupmoshe në vitin 2023 norma e papunësisë ishte 19,0, por u ul në 18,4% pas një viti.

Por vendet e punës që krijohen nuk janë stabile, ndër tjerash edhe për shkak të pagave të ulëta e vonesave në to. Ndërsa, [paga](#) mesatare në Kosovë bruto është 639 euro, meqë pagesa në bazë të përvojës është më e lartë, të rinjtë paguhen dukshëm më pak.

Kjo papunësi strukturore ka ndikuar që shumë të rinj të përballen me probleme të shëndetit mendor, të [rënduar](#) akoma shkak i inflacionit që nga viti 2020.

## Zgjedhja qeveritare

“Punë dhe Drejtësi”, ishte zotimi kryesor i Albin Kurtit gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e jashtëzakonshme të vitit 2021.

Më 6 shkurt, 2023, Kurti bashkë me ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve [lansuan](#) programin “SuperPuna”, aso kohe synonte të punësonte grupmoshat 18-25 vjeç, duke i subvencionuar me pagën minimale e cila atëherë ishte 264 euro bruto, kjo për periudhë gjashtë-mujore.

Ministri Murati kishte deklaruar se synonin punësimin e 10 mijë të rinjve në vit. Si mundësi punëdhënësit mund të shtonin para mbi pagën bazë sa të donin. Ky komunikim do të realizohej përmes një platforme të krijuar ku bizneset dhe punëërkuesit do regjistroheshin, varësisht veprimtarive të interesuara do arrinin bashkëpunim.

Synim i “Super Puna”, ishte që të ndihmonte të rinjtë që kyçen në treg, si një ndihmesë nga shteti.

Me kalimin e kohës disa elemente janë ndryshuar në këtë program. Fillimisht është zgjeruar mosha e atyre që mund të aplikojnë, për t’iu mundësuar të rinjve deri në moshën 29 vjet. Po ashtu është rritur edhe paga bazë 350 euro, sipas rritjes së pagës [minimale](#) më 28 gusht 2024. Qeveria synon që brenda vitit 2026 të rris pagën miniamle në 500 euro.

Kohëzgjatja e subvencionit është gjashtë muaj, ndërsa mund të aplikojnë të rinjtë që nuk kanë punuar gjatë tre muajve të fundit.

## Rezultatet e Super Puna

Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK), operon në kuadër MInistrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Kjo agjenci është përgjigjur në pyetjet e Gazetës Express në lidhje me programin “Super Puna”.

Sa i përket numrit të përfituesve nga “SuperPuna”m APRK tregoi se në vitin 2024 përfitues kanë qenë 6 mijë e 741 të rinj, ndërsa në vitin 2025 janë 7.526 sosh. Në asnjërin vit nuk realizuar synimi i Qeverisë për punësimin e 10 mijë të rinjve në vit.

# Buxheti i Super Puna

Sipas të dhënave të APRK, total i subvencionimeve për vitin 2024 ka qenë 9,830,356.00 €, ku janë bere 35,361 pagesa për te gjithë përfituesit e skemës.

Ndërsa, total i subvencionimeve për vitin 2025 ka qenë 17,341,284.00 €, ku janë bere 49,546 pagesa për te gjithë përfituesit e skemës.

Për vitin 2026, buxheti i planifikuar për Masat Aktive të Tregut të Punës dhe Garancia Rinore dhe skemat tjera të punësimit është 25.800.000 €.

## Numri i monitoruesve të programit

Monitorimi realizohet nga Zyrat e Punësimit përmes Këshilltareve të Punësimit. Në të janë angazhuar 85 staf shtese ne cilësinë e monitorimit të skemës.

"Monitorimi i cili realizohet nga Zyrat e Punësimit, raportohet ne Sekretariat çdo muaj. Ne këtë kontekst, nuk është bere ndonje vlerësim i efektshmerisë se skemës mirëpo sa i përket raporteve zbatimi i skemës vlerësohet i mire pasiqe janë duke u respektuar termet dhe kushtet e skemës", thuhet në përgjigje.

APRK ka treguar për kriteret e monitorimit të cilat janë: *Verifikojnë praninë fizike të përfituesit në vendin e punës; Sigurohen që përfituesi është duke kryer detyrat sipas pozicionit të përcaktuar në marrëveshje; Respektimin e orarit dhe angazhimin e punëmarrësit; Ndërveprojnë me punëdhënësin (kur është e mundur) për të mbledhur vlerësime shtesë mbi performancën dhe përkushtimin e përfituesit.*

Siç tregon kjo agjenci, gjatë vitit 2025 janë 7.331 monitorime të realizuara.

## OJQ-ja "Vizioni Rinor i Shalës" denoncon vonesa dhe probleme teknike me "Superpunën": Asnjë pagesë që nga shtatori 2025

Leotrim Pajaziti, drejtues i organizatës joqeveritare "Vizioni Rinor i Shalës", ka ngritur shqetësime serioze lidhur me funksionimin e platformës shtetërore "Superpuna", duke raportuar vonesa të zgjatura në alokimin e mjeteve dhe probleme teknike që, sipas tij, po e pamundësojnë zbatimin normal të programit.

Sipas Pajazitit, organizata ka përdorur dy herë platformën "Superpuna" për angazhimin e punonjësve, kryesisht për koordinimin dhe menaxhimin e zyrës në fshatin Shalë të Komunës së

Lipjanit – fillimisht në vitin 2024 dhe më pas në vitin 2025, ku angazhimi vazhdon ende.

“Herën e parë kur kemi angazhuar një punëtorë, secila pagesë që duhej të alokohej në xhirollogarinë tonë bankare është vonuar së paku dy muaj. Në fund, gjatë mbylljes financiare të vitit fiskal, është parë se mungon alokimi i pagesës së gjashtë, ndonëse punëtorja ishte angazhuar për gjashtë muaj, aq sa është edhe mbështetja e Qeverisë së Republikës së Kosovës”, ka deklaruar Pajaziti.

Ai thekson se situata është përkeqësuar në angazhimin e dytë. Sipas tij, nga muaji shtator 2025 e deri në shkurt 2026, asnjë pagesë nuk është alokuar në xhirollogarinë e organizatës për punëtorin e angazhuar përmes këtij programi.

“Nga shtatori 2025 e deri më sot, asnjë pagesë nuk është alokuar në xhirollogarinë tonë për pagesën e punëtorit të angazhuar”, ka thënë ai.

Pajaziti ka bërë të ditur se organizata ka kontaktuar në mënyrë të vazhdueshme Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, si dhe Helpdesk-un e platformës “Superpuna”, por pa marrë përgjigje konkrete.

“Që disa muaj kemi kontaktuar Agjencinë e Punësimit dhe Helpdesk-un e platformës, mirëpo asnjëra palë nuk ka ofruar përgjigje, pavarësisht se ne kemi kryer me rregull çdo muaj pagesat e tatimeve dhe kontributeve pensionale për punëtorin”, është shprehur ai.

Sipas tij, arsyetimi i institucioneve ka qenë se ka pasur kthime të mjeteve për shkak të tentimit të alokimit në një xhirollogari të vjetër, të cilën organizata nuk e përdor më. Megjithatë, Pajaziti thekson se platforma nuk lejon ndryshimin e të dhënave bankare për shkak të problemeve teknike që, sipas tij, janë të njohura prej kohësh.

Platforma nuk lejon fare ndryshimin e kësaj të dhëne, si shkak i problemeve teknike që janë tashmë të ditura që një kohë të gjatë dhe që nuk janë rregulluar. Pra, pa fajin tonë, institucioni përkatës nuk ka alokuar mjetet e nevojshme në llogarinë tonë, duke shkelur vetë vendimin dhe kriteret përkatëse për mbështetje”, ka theksuar Pajaziti.

Ai rikujton se, sipas rregullave të programit, paga duhet të alokohet në muajin pasues, pasi të përfundojë muaji paraprak i punës.

“Platforma nuk lejon fare regjistrimin e punëkërkuesve të rinj, duke pamundësuar angazhimin e punëtorëve nga ne si organizatë apo nga bizneset. Kjo po arsyetohet me përditësime në



platformë, por kjo pamundësi është e evidente mbi katër muaj, gjë që nuk e arsyeton fare arsyetimin e përgjegjësve të platformës 'Superpuna', ka deklaruar ai.

Sipas drejtuesit të "Vizioni Rinor i Shalës", këto probleme jo vetëm që krijojnë barrë financiare për organizatat dhe bizneset, por edhe rrezikojnë të dëmtojnë besimin në një program që synon mbështetjen e të rinjve dhe nxitjen e punësimit në nivel lokal.

## Përfaqësuesit e bizneseve: Super Puna nuk po funksionion



Platforma shtetërore "Superpuna", e cila synon të lehtësojë ndërmjetësimin mes bizneseve dhe punëkërkesve, po përballet me probleme serioze funksionimi që nga fundi i vitit të kaluar.

Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës, Kushtrim Ahmeti, ka deklaruar se bizneset kanë raportuar vështirësi të vazhdueshme në përdorimin e platformës që nga muaji nëntor 2025.

"Nga muaji nëntor i vitit 2025, bizneset kanë raportuar tek ne për telashet e para që i kanë pasur në përdorimin e platformës Superpuna, pa e pasur asnjë informatë se pse po ndodh kjo", ka thënë Ahmeti.

Sipas tij, situata është përkeqësuar gjatë muajit dhjetor, kur platforma ka kolapsuar plotësisht, duke pamundësuar regjistrimin e punëmarrësve dhe punëkërkesve.

"Platforma gjatë dhjetorit ka kolapsuar në tërësi, duke ua pamundësuar punëmarrësve dhe punëkërkesve që të regjistrohen", ka shtuar ai.

Ahmeti ka bërë të ditur se pas kërkesës zyrtare të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës për sqarime, kanë pranuar një përgjigje nga menaxhmenti i platformës, ku konfirmohet se problemi ende nuk është zgjidhur.

"Pas kërkesës sonë si Dhomë e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, nga Superpuna kemi marrë një përgjigje ku konfirmohet se platforma nuk është rregulluar akoma dhe se janë në pritje që ky problem të zgjidhet", ka deklaruar Ahmeti.

Ai ka theksuar se vetëm pas reagimit të Dhomës, në platformë është vendosur një njoftim për përdoruesit.

"Vetëm pas kërkesës tonë, platforma ka vendosur njoftimin: 'Superpuna është duke u përditësuar. Regjistrimi do të iu mundësohet së shpejti!'", ka theksuar ai.

Mosfunksionimi i zgjatur i platformës, sipas Ahmetit, ngre dyshime serioze dhe po krijon pasiguri te bizneset që synojnë të përfitojnë nga programi.

"Mosfunksionimi i gjatë i Superpunës na sjell dyshime se kjo po ndodh qëllimshëm për t'ua pamundësuar bizneseve që të mos mund t'i regjistrojnë punëtorët që i kanë punësuar dhe të mos mund të përfitojnë nga ky projekt", është shprehur ai.

Sipas tij, situata aktuale rrezikon të dekurajojë bizneset që të angazhojnë punëtorë të rinj përmes këtij programi, duke cenuar qëllimin kryesor të tij – rritjen e punësimit dhe mbështetjen e sektorit privat.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës ka kërkuar që problemi të zgjidhet sa më shpejt dhe të ketë transparencë të plotë lidhur me arsyet e ndërprerjes së funksionimit të platformës.

## Dreshaj: Probleme me procesimin e pagesave në "Superpuna", po krijohet konfuzion mes punëdhënësve dhe të punësuarve



Edhe Lidhja e Bizneseve të Kosovës ka ngritur shqetësime lidhur me funksionimin e programit "Superpuna", konkretisht për vonesa dhe probleme në procesimin e pagesave për stafin e punësuar përmes këtij projekti.

Kryetari i Lidhjes së Bizneseve të Kosovës, Besart Dreshaj, ka deklaruar se shumë biznese janë ankuar për vështirësi teknike që po ndikojnë drejtpërdrejt në ekzekutimin e pagesave.

"Shumë biznese janë ankuar se po kanë probleme me procesimin e pagesave për stafin që po punësohet me projektin Superpuna", ka thënë Dreshaj.

Sipas tij, problemet lidhen me sistemin e programit dhe bartjen e të dhënave në sistemin e pagesave, çka po shkakton paqartësi në terren.

"Siç duket, po ka probleme me procesimin dhe sistemin e programit, pastaj me bartjen tek sistemi i pagesave. Në fund po krijohet konfuzion në mes të të punësuarit dhe punëdhënësit", është shprehur ai.

Megjithatë, Dreshaj thekson se programi nuk mund të cilësohet si i dështuar, pasi sipas tij ka dhënë rezultate, sidomos për të rinjtë që hyjnë për herë të parë në tregun e punës.

"Ky program nuk mund të themi se është i dështuar. Ka dhënë rezultate deri diku sa i përket fillestarëve në tregun e punës", ka deklaruar Dreshaj.

Ai ka bërë të ditur se Lidhja e Bizneseve të Kosovës ka kërkuar që kohëzgjatja e përfshirjes në program të zgjatet në një periudhë njëvjeçare, me qëllim që të rinjtë të përgatiten më mirë për tregun e punës.

"Si Lidhje e Bizneseve të Kosovës, kemi kërkuar që të bëhet periudha njëvjeçare, sepse kjo periudhë do t'u japë mundësi të rinjve të përgatiten për tregun e punës dhe të bëhen të gatshëm për të kontribuar, si dhe të sigurojnë më pas një vend pune të qëndrueshëm", ka theksuar ai.

Në të njëjtën kohë, Dreshaj ka kërkuar reduktim të burokracisë dhe lehtësim të procedurave për punësimin e të rinjve.

## Gërzhaliu: "SuperPuna" po degradohet nga vonesat, mungesa e transparencës dhe ndikimet politike

Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Ğerxhaliu, po ashtu ka ngritur shqetësime serioze lidhur me mënyrën e funksionimit të projektit "SuperPuna", duke theksuar se problemi nuk qëndron vetëm te aspekti teknik, por edhe te mënyra e menaxhimit dhe përfshirjes së përfituesve.

Sipas tij, projekte të tilla në Kosovë shpesh shoqërohen me favorizime politike, çka e vështirëson realizimin e qëllimit të tyre.



"Problemi është që në Kosovë përmes këtyre projekteve shumë më tepër vështirësohen proceset nga fakti që shumë më shumë përfitojnë familjarët e militantët politikë. Shumë pak ka hapësirë për pjesën që nuk janë pjesë e këtyre taborëve", ka deklaruar Ğerxhaliu.

Ai ka kritikuar edhe mungesën e funksionalitetit të mekanizmave informues dhe aplikues të projektit.

"Ka qenë një zyrë që ka shërbyer për çështje informative, por ka qenë shumë joaktive. Ka pasur uebfaqe që shumë më tepër ka qenë jofunksionale sesa në dispozicion për aplikim", është shprehur ai.

Sipas Ğerxhaliut, një nga ankesat kryesore që vijnë si nga bizneset ashtu edhe nga të punësuarit, është mungesa e komunikimit dhe vonesat e gjata në pagesa.

"Ankesa kryesore që vijnë qoftë nga bizneset, qoftë prej vetë të punësuarve është mungesa e një komunikimi të mirëfilltë, mungesa e informacioneve. Mbi të gjitha është vonesa e pagesave, ku të rinjtë po demotivohen me kalimin e kohës, duke u drejtuar te biznesi – biznesi këto nuk i kryen", ka theksuar ai.

Ai ka bërë të ditur se vonesat në ekzekutimin e pagesave arrijnë nga tre deri në pesë muaj, duke e dëmtuar seriozisht besueshmërinë e projektit.

"Vonesat kalojnë nga 3 deri në 5 muaj, gjë që po e degradon projektin e kësaj ideje që quhet SuperPuna", ka paralajmëruar Ğerxhaliu.

Po ashtu, ai ka përmendur edhe dukuri të tjera shqetësuese në terren.

"Kemi dukuri që ka shumë familjarë, ka raste të marrëveshjeve të ndryshme mes bizneseve dhe të punësuarve", ka deklaruar ish-kryetari i Odës Ekonomike.

Ğerxhaliu ka theksuar se, nëse nuk adresohen me urgjencë këto probleme, nga transparencja, funksionaliteti teknik, komunikimi institucional deri te disiplinimi i pagesave rrezikohet që një projekt i konceptuar për të ndihmuar të rinjtë dhe bizneset të humbasë kredibilitetin dhe efektin

e tij në tregun e punës.

## Rekomandimet

Bazuar në të dhënat, deklaratat e akterëve dhe problematikat e evidentuara në funksionimin e programit "Super Puna", është e nevojshme një qasje më e strukturuar dhe reformuese për të rritur efektivitetin dhe besueshmërinë e tij në tregun e punës. Rekomandimet kryesore janë si më poshtë:

*1. Stabilizimi teknik dhe funksional i platformës:* Funksionaliteti i platformës është parakusht për çdo sukses të programit. Institucionet përgjegjëse duhet të ndërhyjnë urgjentisht për: 1) Eliminimin e problemeve teknike që pengojnë regjistrimin dhe përdorimin; 2) Mundësimin e përditësimit të të dhënave (veçanërisht atyre bankare); 3) Garantimin e aksesit të pandërprerë për bizneset dhe punëkërkuessit. Në këtë drejtim, rekomandohet edhe kontraktimi i ekspertizës së jashtme profesionale për auditim teknik të sistemit.

*2. Disiplinimi i pagesave dhe transparencë financiare:* Vonesat e pagesave përbëjnë problemin më serioz në implementim. Duhet të vendosen mekanizma të qartë për: 1) Ekzekutimin e pagesave brenda afateve ligjore mujore; 2) Publikimin periodik të të dhënave mbi pagesat dhe vonesat; 3) Krijimin e një sistemi automatik njoftimi për përfituesit dhe punëdhënësit.

Nëse kjo nuk garantohet, programi rrezikon të humbasë besimin e aktorëve kryesorë.

*3. Vlerësim i pavarur i efektshmërisë së programit:* 1) Kryerja e një analize të pavarur nga institucione kërkimore apo organizata ndërkombëtare; 2) Matja e indikatorëve kyç si punësimi afatgjatë, qëndrueshmëria e vendeve të punës dhe zhvillimi i aftësive; 3) Publikimi i raporteve vjetore të performancës.

*4. Zgjatja e kohëzgjatjes së subvencionit:* Periudha aktuale prej 6 muajsh është e pamjaftueshme për integrim të qëndrueshëm në tregun e punës. Rekomandohet: 1) Zgjatja e subvencionit në 9–12 muaj; 2) Lidhja e subvencionit me performancën dhe trajnimin e punëmarrësve; 3) Inkurajimi i kontratave afatgjata pas përfundimit të mbështetjes.

*5. Reduktimi i burokracisë dhe lehtësimi i procedurave:* Proceset administrative duhet të thjeshtohen për të rritur pjesëmarrjen e bizneseve: 1) Digjitalizim i plotë dhe më pak i komplikuar procedurave; 2) Reduktim i dokumentacionit të panevojshëm; 3) Krijimi i një pike unike kontakti për asistencë dhe më efikase.

6. *Rritja e transparencës dhe parandalimi i abuzimeve:* Për të adresuar shqetësimet për favorizime dhe ndikime politike, është e nevojshme: 1. Vendosja e kriterëve të qarta dhe të verifikueshme për përfitim; 2) Auditime të rregullta dhe të pavarura; 3) Publikimi i listave të përfituesve dhe punëdhënësve (duke respektuar privatësinë).

7. *Përmirësimi i komunikimit institucional:* Mungesa e komunikimit ka krijuar konfuzion dhe pakënaqësi. Duhet: 1. Funkcionalizimi i një helpdesk-u efektiv; 2) Afate të detyrueshme për kthimin e përgjigjeve ndaj kërkesave; 3) Informim i rregullt publik mbi statusin e programit.

Përmbajtja e këtij artikulli është përgjegjësi e autorit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e donatorëve.

---

Mbështetur nga:

